

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
A 58

*Fatmir
Alimani*

FILLIM STINE



poezi




891.8 83-1

8JH-1
H 58.

*Fatmir
Alimani*

*FILLIM
STINE*

poezi



SHTËPIA BOTUËSE
«NAIM» FRASHËRI

Redaktor

PERIKLI JORGONI

MONTATORËT E UZINËS SË FERROKROMIT

Ç'të shkruaj dora më parë ?
Po gjuha ç'të ligjërojë?

E gdhinë dhe mbrëmë montatorët
që uzina shtatin si përmendore të lartojë.
E gdhinë dhe mbrëmë montatorët.
Ç'të shkruaj dora më parë?
Po gjuha ç'të ligjërojë?

Është pak të shënosh fjalën «heroizëm»,
është pak të thuash «janë heronj»,
është pak t'i quash «brumçeliktë».

Zvarritu, e egra bllokadë!
Qdonjeri prej tyre është dhe top i rëndë,
dhe kala e gjallë.

NJËMBËDHJETË TRËNDAFILË TË BARDHË

Të njëmbëdhjetë ishin sondistë,
të njëmbëdhjetë luanë të maleve ishin,
të njëmbëdhjetë vdekjen e mundën,
të njëmbëdhjetë.

Të njëmbëdhjetë të qeshur, zemërzarritë,
të dashur e gojëmjaltë,
të njëmbëdhjetë besnikë e të vendosur,
të njëmbëdhjetë.

Mbrëmjeve shokët në Batër-Martanesh
këndojnë për shokët një këngë:

Njëmbëdhjetë vellezër të dashur zunë ortekët e borës,
njëmbëdhjetë trëndafilë të bardhë bjeshkave mbinë,
dhe kënga ngriti njëmbëdhjetë male të rëndë.

Të njëmbëdhjetë ishin sondistë,
akoma të gjithë s'e kishin teserën e Partisë,
por të njëmbëdhjetë ishin komunistë,
të njëmbëdhjetë.

NË KSAMIL

Deti i thellë hap tejembanë flatrat e kaltra,
trokun e zemrës së tij vigane kaq pranë e ndiejmë.
Pemët pyesin: Ç'rrugë po nisni, dallgë udhëtarë,
flladet ç'ju thonë, ç'ngjyra përbrenda ju sh'këlqejnë?

Heshtim dhe ne, aksionistë nga gjithë anët e atdheut,
tek rrëmojmë dheun e mbjellim portokallë e limonë,
të dëgjojmë si bie daullja e dallgëve,
si tromboni i erës ia merr një kënge që tutje gjëmon.

SEKRETARI I PARTISË

E kam takuar sekretarin e Partisë buzë arës,
e kam dëgjuar kuvendin e tij me shokët e bazës,
e njoh shqetësimin e tij për mbirjen e farës,
e njoh rreptësinë e tij për armikun e klasës.

Ai pranë bujqve e punëtorëve në frontin e punës,
me fshatarët mbart bukën e re përmes shiut,
në fushat e blerta a tej në male me malësorët
punon pranë të gjithëve me vrullin e të riut.

Thinjat si serma e bardhë i ndritin në flokë
atij, punëtorit të Partisë, ngarkuar nga mendimi i
klasës,
atij, që dhe për një kokërr gruri shkelur mbi tokë
i dhemb po aq, sa dhe shëndeti i dobët i nënës a i
vajzës.

VALLE E VERIUT

Qeshja e tupanave gjer në qiel,
buzëgazi i çiftelisë ngjall njëriun nga vdekja,
përplasja rrufe e shpatave si në mejdan,
ritmet zjarre ndezin në zemra.

Fluturon një flutur veshur me xhubletë,
sytë e trimave të mahnitur pas saj,
shkojnë e vijnë vajza e djem sup më sup,
hajde mos këndo gjer në agim pastaj.

Dhe malet lëvizin brenda odës
dhe fushat lulëzojnë aty brenda,
të flasë kaq shumë gjuha e valles,
ndodh vetëm kur e lumtur ështëjeta.

* * *

Të bukur nuk janë vetëm sytë e kaltër,
të bukur s'janë vetëm flokët e verdhë,
bukuria fshihet dhe në pak ajër të pastër,
bukuria çel dhe në gurë dhe në fshatin më të thellë.

Të bukura s'janë kuvendet me lajka,
as fjalët që nga fryn era u kthehet guna.
Të bukura janë duart e ndërtuesve, ku thërrmohet
bllokada,
të bukura janë duart që nderin e gjejnë tek puma!

LOT LUMTURIE

Pranvera erdh. Çelën lulemollët.
Në rresht ngajnjë si nuse të reja
Veshur me fustan të bukur nusërie.

Flladi violinave me ç'ëmbëlsi u bie,
mollët dridhen nga gjëzimi e fëshfërijnë.
Petale lulesh e pikla vese bien.

Janë lot gjëzimi, lot lumturie!

RRJEDH GËZIMI NË GËZIM

Pikoi zemra në zemër
dhe u bënë një,
djali shtatçetinë,
vajza fytyrëhënë.

Pikoi syri në sy
dhe u bë një yll.
Ç'po ndritka ai
në fshatin e ri!

Bilbili dhe thëllëza
rrinë te qershia,
djali nga Tirana,
vajza nga malësia.

Pikon djersa det
dhe bëhet një kala,
fshatin si qytet
qëndisin ata.

VAJZAT E BREGUT TË DRINIT

Ca plepa ndanë bregut.

Ecin ato, sikur lëviz një tufë zambakësh
nëpër arë.

Ecin ato. Punojnë dhe çelin këngë zemre,
sikur një copë qielli me yje
është ulur në luginë.

Dhe kur ndodh që ato të gëzuara këndoijnë,
lumi duket sikur ndal rrjedhën
e plepat harrojnë të fëshfërijnë.

I KAPTOJ SËRISH...

Po shkoja në një dasmë, diku thellë,
tej në nëntë malet e Dibrës.
Më thotë një burokrat me habi:
Ç'degdisesh gurëve e rrëpirës!

Mes fshatarëve gëzova dhe këndova
dhe me nusen vetë hoqa valle.
Për gëzimin që ndieva, shokë,
i kaptoj sërish dhe një mijë male.

MIRËMËNGJES, GËZIM!

Unë eci në rrugët e gëzuara
skaj më skaj Shqipërisë,
dhe pemët, dhe gurët dhe gjithçka
gëzojnë prej lumturisë.

Eci. Së bashku me mua merr frymë gëzimi,
siguria e jetës sime të lirë
dhe bukuria e bukurive,
koha jonë që rrit njeriun e ri!

RETROSPEKTIVË

Iku ajo kohë,
kur burrat humbnin kurbeteve,
gratë çirrnin faqet si në vdekje,
dhe nuset me thinja
prisnin burrat të vinin,
që fëmijë të lindnin.

Dhe kur kthehej një plak,
në torbën e vjetër kish sjellë:
një mal me lot,
ca thërrime bukë,
mallin e madh për mëmëdhënë
dhe tre katër ditë jetë.

Natën e tretë, a të katërtën natë
e shtrinin në varr,
nga lotët e mënës mbinte një baladë,
nga vaji i gruas thërrisinin fëmijët e ngratë!


MBRËMJE NË LURË

Një hënë eëmbël
vesh pishat e gjelbra
me jelekë të verdhë.

Bilbilat thua nér degë ligjërojnë!

Flladi, pemët, njerëzit
të mahnitur
dëgjojnë.

Shtatë liqej zëkumbues diç thonë
diç thonë shtatë sy të kaltër,
sikur zëri i një malsori gjëmon:
Urdhëroni burra, bukë e kripë
dhe zemër të pastër!



Shetisin njerëzit e lumtur.
Një hënë e ëmbël
vesh pishat e gjelbra
me jelekë të verdhë.

HYRJA E PRANVERËS

Kanatat mbylli dimri kokëulur
mbi majazbardh bora diku akoma,
gjithë zogjtë e bukur
shetisin gjer orëve të vona.

Natyra buzëqesh me nurin e nuses së re
me gaz të blertë ia thotë me kitarë,
në zemrën time s'ë dì ç'po çel
një zambak apo një dashuri e bardhë?

Qielli si në një shoqëri të mirë
më tund përzemërsisht dorën kaltërore,
dhe unë mendoj sesi koha jonë e madhe
bleron në çdo stinë epokën pranverore.

LULJA E DËBORËS

Godet dritaren shiu
dhe unë rend të të shoh ty.

Zogjtë këndojnë nér degëza
dhe unë rend të të dëgjoj ty.

Shokët ikin pas zemrave të tyre
dhe ti mes borës çel buzëqeshur.

Dhe ti mes borës çel buzëqeshur
si lulja e zemrës.

Unë mätëm të këpus lulen
dhe të shoh tek vjen mes dëborës.

KËNGË DIBRANE

Ti dhe unë, oj cucë
mali edhe fusha bashkë.

Ti dhe liqejtë e Lurës
motra të së bukurës.

Ti dhe unë, oj vetullkurorë
e bëjmë malin fushë të lulzojë!

NGA DITARI I NJË MALSORI

Me gjyshin zbritëm ngarbjeshkët
në Tiranë, në vitet shtatëdhjetë,
kur i tregova egjithçka, nai këndoi;
«Tash o bir, i qetë, odo të vdes!»

Në mbrëmje në hotel «Arberia»
ndieja si lëvizte në shtrat i shqetësuar,
dhe ia shihja rrëkerat e kujtimeve,
që në mëndje i vinin pa pushuar.

Kujtimet, në shumë vise e nisnin,
në shumë luftëra e çonin,
tek lëvizte në shtratin me sfungjer,
Naimi e Mici me të bisedonin.

Njohu ai dhembjen e shtypjen në jetë,
pa ushtarët e krajlive, të Duçes e të Hitlerit,
ia dogjën arat e kasollec nëpër netë,
tek rrëmbejin foshnjet prej djepit.

Vetëm në vitet tona plot drithë
ai jetoj, të ëndërruarën, lirinë e vërtetë,
i këndoi zemra për gjithë mrekullitë,
që koha jonë bleroi në jetë.

U bënë vite që ai nuk është më,
ka vite që dergjet nën një lis i vdekur,
po rrudhat e ballit dhe gjuha e syve të tij
nga mendja e zemra s'më janë tretur.

SKËNDERBEUT

Qysh në gjithëve malet na mësuan
që jetën ta kuptionim vetëm me liri.
Le të falej bota nér kisha e tempuj të mykur,
ne luftonim me betimin: pasha dritën, Shqipëri!

Nér shekuj yje lirie patëm shumë
midis tyre ti, Gjergj, ngrihesh si flamur,
dhe nëse të quanin kryetrim e të parin e shpatës,
kjo ndodhi se s'i ktheve kurrizin erërave dhe dallgës!

Ty shqipet ta bënë zemrën kështjellë,
ty shqipet ta bënë dorën vargmal,
çmund të bëje i vetëm, o Gjergj,
pa bijtë e tu, pa popullin luftëtar!

Pse ishe shkëmb i patundur në mes shqiptarëve male,
pse ishe ushtar e komandant i një populli zemërjarr,
ndaj thyheshin rrëthimet e përballej lufta,
ndaj qëndronin në këto shkrepë të pamposhtur e
krenarë.

Vjeshtave, vit pas viti, ditë e natë
gjeneralë, vezirë, sulltanë i knin të mundur e të
turpëruar
me dhembjen e disfatës në shpirt
nën gjëmë resh e malesh të egërsuar!

I vetëm një popull me Gjergjin sfidoi perandoritë, mbrojti nën gjëmime lufte vatrën dhe tokën, sepse kur është fjala për nderin dhe lirinë shqiptarit asnjë tufan s'ia ul dot kokën!

SHKATËRIMI I KËSHTJELLAVE

Bejlerbeu i Rumelisë, në një mijë e tetëqind e
tridhjetë, pasi organizoi masakrën e udhëheqësve shqiptarë,
sërisht s'e ndjeu veten aspak të qetë
dhe mendoi shpejt një masakër të paparë.

Të vritten njerëz përsëri? Jo! Të digjen? Jo, pra!
Ai urdhëroi shkatërrimin e kështjellave shqiptare.
Pamja e tyre — thosh bejlerbeu, më kujton ata,
dhe ndiej sikur më mbërthejnë ca kthetra në varre.

Dhe u sulën mbi kështjellat hijerënda.
Ç'betejë e lavdishme donkishoteske!
Mbi muret përplaseshin gjylet, hobet, shpatat,
krerët u vranë në dredhi, kalatë në përlleshje.

Dhe muret gjymtoheshin njëri pas tjetrit,
po frika osmanëve u rritej si ortek i fuqishëm.
Ata në çdo çast shihnin trimat të shfaqeshin
nga çdo gur, të tmerrshëm e të çuditshëm.

Hordhitë pambarim suleshin
mbi kalatë e qëndresës shqiptare,
pa mësuar kurrë se zemrat e popullit
ishin kështjellat përitë cilat s'mund të ketë varre.

VDEKJA E TRIMIT

E dëgjuan shtëpitë dhe u lëkundën,
e ndien tërmjetet dhe u stepën,
çiftelitë në muret e kullave
zunë të binin vetë.

BALADA E KRISTOFORIDHIT

Njëzet vjet kërrusur
rri përmbi fjalor,
fjalë mbledh në fusha,
në male me borë.

Në shqotë dhe në erë,
në fllad e thëllim,
s'lodhet duke bredhur
udhët pa mbarim.

Popullit ia merr,
popullit ia kthen,
shqipja jonë e ëmbël
ndizet e shpërthen,

aty porsi lule
rritur nē lēndinē,
aty porsi yjet
shkrep e vetētin.

Aty porsi shqotë
shfrym edhe gjëmon,
sikur bregu e deti
egër shungallon!

Dher tek fjalë shkruan
buzën vë në gaz:
ç'vrull e ç'embësi
derdh ajo çdo ças!

Ç'fshikullon e shpon,
ç'zien e oshëtin,
sikur flakë rrufesh
grykash shkrepëtijnë!

Ndaj me ngulm Turqia
e pesë fuqitë,
duan që ta mbysin,
t'ia fshijnë bukuritë!

Ndaj konsuj tē huaj
nga pese fuqitē;
si kusarë e ujqër
kurdisin dredhitē.

Kush ta vjedhë më parë,
Fjalorin t'ia zhdukë,
në bodrum ta mbyllë,
vrimave ta strukë.

Shtatë pash në dhë
ta fusë tē gjallë,
dë çdo osmanlli
e çdo diplomat!

Dheu ynë lëngon
në mjerim, pa dritë,
por në thellesi
mbledh gjithë stuhitë!

Kot mundohet turku
me thikë e hanxhar,
të zhbijë ç'ka mbjellin
burrat zemerjarr.

Kot mundohet turku
dhe pesë fuqitë,
këtë dhé s'e mposhtin
lajkat e dredhitë.

Se nga gji i tij
ja ku del Naimi,
ja ku del Isai
edhe Kostandini.

Nga barku i vet
lind trima azganë,
që s'i trembin plumbat
dhe asnje dushman.

Ndaj dhe Kostandini
dru shet dhe qymyr,
dhe turkut katran
i thotë mynxyrë!

Edhe fjalë mbledh
ngado që 'kalon,
dhe kur fryn thëllim,
dhe kur shungallon;

dhe kur udhës balta
nxin edhe zë thinjë,
ai çan me qerre
me trastën mbi shpinë,

që t'ia mbledhë fjalët
popullit të vet,
që rrон nér kasolle
e lëngon e heq!

Dhe kështu mes punës
ai ballin ngre,
dhe beson se zgjedha
s'do rëndoje gjithnjë,

se ky dhe i tij,
që kaq jetë ka,
në këngë e në valle
s'të bën temenà!

Se ai do ngrihet
dhe do të fitojë,
do t'i shporrë armiqtë,
dhe i lirë do rrojë!

FLETË NGA KOMUNA E PARISIT

Komunës,

proletarët parisianë,
me gjakun e tyre

i dhanë nér shekuj lavdi!
Rrokullisen ngjarje

dhe vite plot zhurmë e gjëmë,
po dielli i Komunës
shkëlqen plot jetë e bukuri!

U kalbën, u thanë

kurorat e mbretërve,
Stemat dhe reliket e tyre

askush më s'i kujton,
por plumbat që gjakosën në rrugët e Parisit

fëmijët

dhe gratë e komunarëve
as Sena,

as zemra e njerëzve
s'i harron.

Qëllonin gratë e oficerëve
me revolverë

nga dritaret e ballkonet,
mbi fëmijët e gratë,

që bartnin trupat e luftëtarëve,
që skuqnin e nxinin
nër hendeqe e udhë.

Dhe qeshnin, oh qeshnin
prostitutat

e fabrikantëve,
e bankierëve,
dritë llampadarësh u binte
në shpatullat e zhveshura

pa dregëz plagësh e rrudhë!
«Kjo është magjepsëse, —
thonin bankierët dhe oficerët, —

ky është sukses

i kohës sonë të madhe e të hekurt,
kjo do të thotë se përkrah nesh,
përkrah ushtrisë së mbretërve

radhitën edhe gratë
e dashnoret tonë.

Madje, po ta lypë nevoja,
dhe çupat e fëmijët,
që në këtë orë flenë shtretërve!»

Qeshnin zonjat,
të lyera me pudër e parfum,
qeshnin zonjat
dhe ngrimin lart plot mburrje
pushkët e revolverët,
orkestra luante valse,
kureshtarët mblidheshin tek dera,
ndërkaq fëmijët e komunarëve
i ngrinte përjashta era
dhe plumbat e pabesë
u nguleshin në brinjë e shpinë!

Borgjezia
hakmerrej dhe këlthiste:
«T'i vrasim fëmijët
dhe gratë e komunarëve,
Kështu do të varrosim revolucionin!
Të vrasim ditët e tyre,
të ardhmen e proletarëve!».

Klasa punëtore e botës
ngryste nga dhembja ballin,
nër greva, përleshje, beteja,
shtrëngonte radhët e grushtet,
në marshimin e madh
për në fitore të reja!

Në gjirin e saj koha mblidhëte
rrebeshe e shqota të reja, -
që do të përmbysnin mbretëritë
e borgjezinë gjakpirëse,
do ta rrëzonin nga pushteti!

SEPSE NUK FLENË SYTË E MI...

(*Diversionit ideologjik borgjezo-revizonist*)

Ti rrëmon e rrëmon,
hesht e vrenjtesh si dita e dimrit.

Si urithi rrëmon papushim,
kërkon një psherëtimë,
një ankim,
kërkon një kérkesë për kredi
si i mbyturi mes dallgësh
një copë dhogë a dërrasë
për shpëtim.

Unë vigjëloj dhe qesh me ty.
Ti s'mund ta kuptosh se toka ime
s'njeh lot,
se gëzimi është populli im!

Ti je bastard dhe i egër,
të na thyesh ëndërron pa pushim,
të gjesh gjékundi një plasë e një të çarë
që helmin vdekjeprurës
të vjellësh plot gëzim!

Maskat t'i njoh,
nuk flenë sytë e mi,
kurrsesi s'duhet të dremitim,
në duam të rrojmë në liri!

E DI SE...

(*Një proletar përballe pronarit*)

Kot më përrallis përditë, përditë,
mbamë vesh, zoti pronar:
Unë e di se me ty mirësitë
mund të vijnë veç në varr.

Të shoh që shkon e vjen paprerë
e djersën time bën gratacielë,
dhe mirë e di se me ty liria
në burg gjithmonë do të ngejë.

T'i mësova lajkat, dredhat, maskat,
ta njoha shpirtin tënd të «mirë»,
ndaj unë e di se ti je gjarpër
ditën, natën e gjer në të gdhirë.

Fëmijët e tu bredhin trupshëndoshë,
biri im vdiq mbrëmë nga uria,
prandaj, që djali tjetër të jetojë,
duhet përmbysur shteti juaj dhe skllavëria!

LATA L XONIJE MBRËMË

(Limi i kësaj e shkrua e Përmbytjeve)

Siç është që t'ju i kthej
dhe që dëgjohet që
t'ju i kthej
dhe që dëgjohet që

Siç është që dëgjohet që
t'ju i kthej
dhe që dëgjohet që
t'ju i kthej
dhe që dëgjohet që

Siç është që dëgjohet që
t'ju i kthej
dhe që dëgjohet që
t'ju i kthej
dhe që dëgjohet që

FATI I ZONJËS MARGARET

(*Pamje nga bota e dollarit*)

Qau dhe qau mbi varr të qenit
me dyzet palë lot,
u lig, u sëmur, u tret
zonjëza e shkretë.

Njësoj si për qenin
në këmbë u ngrit një shtet,
të murrëtyer faleshin priftërinjtë,
binin këmbanat, ndritnin qirinjtë.

E ku s'i morën mjekët,
ku s'i kërkuan ilaçet?
Po zonja fishkej e ligej,
qante e tretej.

Një natë në zi u gdhi shteti.
Vdiq ajo, oh, vdiq Margaret!
Pëshpëritën llafe, dikush shkroi në gazetë:
Malli i qenit vrou zonjën Margaret!

Klithën sensacionet.
Rëndësia u ra fatkeqësive krejt,
për bri fotografisë së saj flisnin gazetat
për skandalin e Uotergejt!

KUNTRUMI

zëmra e tijtumit është njëri i përgjithshëm
dëshirues i kësaj posaçëse qëdo tiflo është
mikrof telephonë e kushtuar shkriv-
ja e informacioneve që e vlerësohet nga

informacione e tij. I tijtumit është që
stafiq është ob iku brëndës se
ani e tijtumit kaqësive-siguri qëndron
tëndai tjetria jashtë shtëpisë së tij; tijtumet e tij

veprimi i tijtumit është qëndron
tëndai, qëndron e tijtumit qëndron
përveç tjetri, qëndron e tijtumit qëndron

lisena libq o is ëm sëmundje
lloqazgjali pibv do oja pibv
ështet që i kështë mësuarët e lloqazgjali
ështet që i kështë mësuarët e lloqazgjali

KUPTIMPLOTE
KUPTIMPLOTE
KUPTIMPLOTE

Përpara zyrës së ministrit të punës
(të cilit shtet borgjez s'ka rëndësi),
priste turma e madhe plot durim
për kërkesën e vjetër, për formulimin e ri.

Atë ditë ministri i tha sekretarit
se askënd nuk do të priste,
një punë urgjente-theksoi ministri, e iku.
Tha sekretari: Në ç'hall, thua, shteti ishte?

Vetura fluturonte drejt detyrës urgjente:
Në hotelin me emrin «Ç'kuptim ka nderi»,
priste lozonjarja,
prostituta Virxhinia Roxheri.

Përpara zyrës së ministrit të punës,
(të cilit shtet borgjez s'ka rëndësi),
mos prit kurrë të zgjidhësh mjerimin, proletar,
atë që mund ta zgjidhësh drejt vetëm vetë ti.

IMPERIALISTI

„Dëshironi a jehi emri i tui
dëshironi a jehi emri i tui
dëshironi a jehi emri i tui
dëshironi a jehi emri i tui

obegj vijent është mëdha nuk
dëshironi a jehi emri i tui
dëshironi a jehi emri i tui
dëshironi a jehi emri i tui

zgjidhësh s'ka dëshironi a jehi emri i tui
dëshironi a jehi emri i tui
dëshironi a jehi emri i tui
dëshironi a jehi emri i tui

NEOKOLONIALİZËM

Nën ritme tuist e rrokenroll,
në bankete e koktej premtimi,
thithin gjak proletar
shushunyat nga Lindja e Perëndimi.

Shesin helm në tregje ngado
dhe premtojnë ndihma të shumta,
e të qetë tjerrin rrjetën e zezë,
e po u desh shpejt nis edhe lufta.

Të lajnë e të lyejnë mrekullisht
me lumenj frazash e deklarata,
dhe popujve kështu «miqësisht»
u shkon skllavëria, shtypja, nata.

Dhe tek rrinë pamjeqetë në tryeza
fshehtas djallëzisht CIA diku komploton,
të nesërmen gazetat sensacione batojnë:
«Puç në Persi. Grusht shteti në Singapor!».

Popujt të zgjuar sot 'këtë e kuptojnë
dhe flasin me greva, plumba, përleshje.
Milionat në Iran Amerikën sfidojnë
e lakun «kredi» çojnë drejt vdekjes.

SI KAM PARE...

S'i kam parë rrugët e tua, Iran,
por kam ecur bashkë me demonstruesit,
dhe kemi thirrur së bashku pa të lutura:
Jashtë superfuqitë! Poshtë mashtruesit!

Dhe zoti Xhimi Karter, dhe zoti Brezhnjev,
që të dy janë shqetësuar, kanë temperaturë,
Nga se u vjen? — mos pyetni më kot,
asnjë mjek s'mund ta gjejë përse ndihen të sëmurë.

E keqja s'u vjen nga oreksi,
ethet ua sjell nafta e gazi i prerë, qyteti Tabas,
një popull i tërë që dërrmon zinxhirët e tyre,
revolucioni që shekulli ynë i shqetësuar mbi vete
mbart.

KËNGË NEGRE

Pse jam i zi, vuaj,
dhe shoku im i bardhë vuan.

S'është fjala te ngjyra,
gjithçka është keq këtu,
botës po s'iу ndërrua fytyra...

Pse jam i zi, vuaj.
Jeta ime
simbol i antidekomracisë sate,
Amerikë e neveritshme dhe plakë!

DY URDHËRA TË GESTAPOS NË LUFTËN E DYTË

1.

(*Në fillim të luftës*)

«Urdhërojmë,
që askush të mos ketë fytyrë të trishtuar,
sepse çdokush duhet të ketë fytyrë të gëzuar,
me çdo kusht, shpejt, urgjent!

Në mos, kushdo qoftë
menjëherë të vihet në arrest,
gjersa të mësohet të mënjanojë trishtimin rebel
nga koka e tij mendimetrazuar,
që më në fund edhe ai të kuptojë im themel
që të jesh i trishtuar, është rreptësisht e ndaluar!».

2.

(Në mbarim të luftës)

«Urdhërojmë,
që askush të mos ketë fytyrë të gëzuar,
sepse çdokush duhet të ketë fytyrë të trishtuar,
me çdo kusht, shpejt, urgjent!
Në mos, çdokush qoftë
menjëherë të vihet në arrest,
gjersa të mësohet të mënjanjojë gëzimin rebel
nga koka e tij mendimetrazuar,
që më në fund edhe ai të kuptojë me themel
që të jesh i gëzuar, është rreptësisht e ndaluar!»

3.

Që kësisoj urdhërash,
më kurrë të mos nënshkruajnë qentë:
Popuj, jini vigjilentë!

AVAZI I NJË GJYQI

(Fshatari kilian Mitero hodhi në gjyq
tre policë, se i kishin çnderuar të bijën)

Nga shtypi

Pesëmbëdhjetë vjet nëpër gjykata,
padia e tij në shqyrtim serioz,
shkonin ditë, vinte sërisht nata,
padia e tij në shqyrtim serioz.

U tret, i vdiq gruaja dhe fëmijët,
padia e tij në shqyrtim serioz,
vdiq dhe vetë dhe ende gjykata
padinë e tij e merr në shqyrtim serioz.

Vazhdoi debati edhe pesë vjetë
A mund të dënohen policët?!
Në fund kryetari dha vendimin:
Të shpalllen të pafajshëm policët!

medvëdëm qërrë is i mësuar
zotibësp bëmëk ba mund te
mësuar em këtobësav atë
llojtazhiv i qëllat e mësuarët sot është

zotib bëmëbës sotët është zotib
zotiq e bëmët zotiq e sotët
zotiq sotët zotib i zotib sot
zotib është zotët zotib i zotib sot

LETRA E NJË MILITANTI NGA BRAZILI

nështë e mështë zotib i zotib
zotibësp që sotët zotibës sotët zotibësp i
zotibësp

Më kanë torturuar shumë,
gjer atje ku s'tregohet dot,
disa me grushta e shkelma,
të tjerët me lajka e me lot!

Dhe supës helm m'i hodhën,
edhe ma dhanë ta pi,
disa të egër si banditë,
të tjerët me djallëzi,

Nuk mundën të më thyejnë,
por sot fytyra m'u nxi.
Nga plagët e rënda në burg
një shok i vdekur u shtri!

Pikëllim i zi s'më mbërtheu,
si burrë në këmbë qëndroj.
Ata vazhdojnë me tortura,
unë me përcnim e tallje i vështroj!

Mundet të vdes ndonjë ditë,
nga ata gjithçka mund të pritet,
por dhe i vdekur mes jush,
do të vij, o shokë, kur bota të ndritet!

Vërej si xhelati shan e ulërin
i çmendur nga lodhja, nga ky qëndrim
krenar.

Mirë e di se vetëm nga lufta e popujve
do të shkrepë mbi dhé agimi rrezear!

„Nëntorin e shtëpia mbi qytetin
Armenia e është riqytet
qëndrueshëm vënët përmes aks
Bënturit shqiptar minilla i t'i

„aqelora është këtij që vjet
domejti si kurrë vijnët që
vend i është llogari është mordetësim i t'i
tështjellës së vjetës së vjetës së

MARSHI I REVOLUCIONIT

Sa dredhira mbi ty ngritën,
gjëmimtari ynë i madh,
herë me plumbë e me helme,
herë me vilë e me temjan.

Nuk t'u ndanë këmbës,
shekujve të historisë,
mercenarë e menshevikë,
llumi sterr i njerezisë!

Edhe bijtë e tu në plumbë
shesheve t'i pushkatuan,
po ku binte pikë e gjakut
qindra yje vezulluan!

Dhe nën dritë vetëtimash,
nëpër erë e suferinë,
ata ecnin nën gjëmime,
t'i sillnin tokës lirinë!

Ty as helmi s'të moleps,
ty as burgu nuk të tremb,
ti marshon në ball' të kohës
si tufan që zjarre ndjell!

Dhe rrufetë kap me dorë,
shkel mbi kurthe e dredhira,
edhe bijtë ngado mes flakësh
grish për ditë më të mira.

Dhe i hedh nëpër beteja,
dhe i hedh përmbi pusira,
dridhet botë e kapitalit,
shemben burgje e zinxhira!

PASQYRA E LËNDËS

| | |
|--|----|
| Montatorët e uzinës së ferrokromit | 3 |
| Njëmbëdhjetë trëndafilë të bardhë | 4 |
| Në Ksamil | 6 |
| Sekretari i Partisë | 7 |
| Valle e veriut | 8 |
| Të bukur | 9 |
| Lot lumturie | 10 |
| Rrjedh gëzimi në gëzim | 11 |
| Vajzat e bregut të Drinit | 13 |
| I kaptoj sërish | 14 |
| Mirëmëngjes, gëzim! | 15 |
| Retrospektivë | 16 |
| Mbrëmje në Lurë | 17 |
| Hyrja e pranverës | 19 |
| Lulja e dëborës | 20 |
| Këngë dibrane | 21 |
| Nga ditari i një malësori | 22 |
| Skënderbeut | 24 |

| | |
|---|----|
| Shkatërrimi i kështjellave | 26 |
| Vdekja e trimit | 28 |
| Balada e Kristoforidhit | 29 |
| Fletë nga Komuna e Parisit | 34 |
| Sepse nuk flenë sytë e mi | 38 |
| E di se | 40 |
| Fati i zonjës Margaret | 42 |
| Kuptomplote | 44 |
| Neokolonializëm | 46 |
| S'i kam parë | 48 |
| Këngë negre | 49 |
| Dy urdhëra të gestapos në Luftën e Dytë | 50 |
| Avazi i një gjyqi | 52 |
| Letra e një militanti nga Brazili | 54 |
| Marshi i Revolucionit | 56 |

Alimani, F.

Fillimi i një stine. Poezi. (Red.
P. Jorgoni), T., «Naim Frashëri»,
1980.

60 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.93-1

A 58

Tirazhi. 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1980